



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRII

Numri i lëndës: 2024:083456

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05560327

P.nr.56/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRII – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurës S.M. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.414/24 të datës 13.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, i datës 04.04.2024, në praninë e Prokurores së shtetit Albana Parduzi, të pandehurës S.M. dhe të dëmtuarit Xh.H., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 04.04.2024, më datë 11.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E PANDEHURA: S.M. nga i ati H., e ëma Sh., e vajzërisë B., e lindur më dt..., në Vushtri, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e pa gjykuar.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE:

I. Më datë 11.03.2024 rreth orës 20:15 minuta në Vushtri, rruga “Zymer Haziri”, në shtëpinë e përbashkët me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit – bashkëshortit Xh.H., si pasojë e mosmarrëveshjeve së vazhdueshme të cilat i kanë në mes veti, në atë mënyrë që gjerë sa kanë qenë duke qëndruar në dhomë së bashku, i dëmtuari me të parë një emër në telefonin e të pandehurës me nofkën “bebushi”, i kërkon sqarime se kush është ky person, e njëjta në shenjë nervoze duke mos dhënë sqarim e gjuan me një vazo e cila kishte qenë në tavolinë në dhomë ku ishin duke qëndruar.

- Me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

II. Më datë 11.03.2024 rreth orës 20:15 minuta në Vushtri, rr. “Zymer Haziri”, në shtëpinë e përbashkët nuk i bindet Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil C.nr.607/24 të datës 29.02.2024, në afat prej një

(1) muaj, sipas të cilit aktvendim palës mbrojtëse – të dëmtuarit Xh.H. i është aprovuar në tërësi kërkesa për lëshimin e urdhrin mbrojtës, që të ndërpresë dhe të mos përsëris asnjë veprim të dhunshëm ndaj palës së mbrojtur, personave në marrëdhënie familjare me të, kafshëve shtëpiake apo të mos e dëmtojë pasurinë, si dhe që të ndalohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes personave të tretë apo çfarëdo lloj mënyre tjetër të komunikimit të ngacmojë, shqetësojë, manipulojë, ofendojë, kërcënojë, përndjekë, apo vëzhgojë palën e mbrojtur apo personave në marrëdhënie familjare me atë, mirëpo pavarësisht kësaj e pandehura prapë ka vazhduar ta shqetësoj duke e sulmuar me vazo si veprim ky i cili ka shkaktuar shqetësim të madh emocional tek i dëmtuari për mirëqenien e tij,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 184 par.1 dhe neni 393 par.1 të KPRK-së dhe neneve 241, 242, 364, 449 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

TË PANDEHURËS: S.M.:

Për pikën I të dispozitivit i shqipton DËNIM MË BURG në kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

Për pikën II të dispozitivit i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej dy (2) muaj.

Me zbatimin e dispozitave të neni 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të pandehurës S.M. i:

## SHQIPTON

DËNIM UNIK me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar Xh.H. ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHET e pandehura që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

*Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.414/24 e datës 13.03.2024, kundër të pandehurës S.M. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184, par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni

393 par.1 të KPRK-së.

*Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.04.04.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që: E pandehura S.M. ka deklaruar se e pranon fajësinë, nuk është penduar për kryerjen e kësaj veprë pasi që pala e dëmtuar e ka merituar dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër.

*Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Pala e dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e saj si dhe njëherit ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje juridike penale.

*Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se e pandehura i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e njëjta, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Raporti fillestar i incidentit i datës 11.03.2024, Raporti ditor i dhunës në familje i datës 11.03.2024, Raporti i oficerit i datës 11.03.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin Xh.H. të dhënë në hetuesi i datës 11.03.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurës S.M. të dhënë në hetuesi i datës 11.03.2024, Aktvendimi mbi caktimin e urdhrit për mbrojtje emergjente i datës 29.02.2024 me numër C.nr.607/24, Fotoalbumi, CD, Fletë lëshimi nga Klinika e Psikiatrisë në emër të pandehurës S.M. i datës 17.10.2017, Informacionet mbi të kaluarën kriminale si dhe shkresat përcjellës të lëndës.

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se e pandehura me dashje ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK –së dhe veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 184, par.1 të KPRK-së është përcaktuar se “Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Në nenin 393 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se *“Kushdo që nuk i bindet ndonjë urdhri, vendimi apo aktgjykimi të plotfuqishëm të ndonjë gjykate në Republikën e Kosovës ose refuzon apo pengon publikimin e vendimit apo aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës së tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.”*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurën ta shpall fajtores për kryerjen e veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtës përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjëse.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, premtimin e të njëjtës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe faktin që më parë nuk ka kryer vepra penale, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurës gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe faktin që vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**P.nr.56/2024, datë 11.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Agron Maxhuni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.